

Fillimi > -Kronikë

Kokainë, armë zjarri e municion luftarak, arrestohen dy të mitur dhe një 27-vjeçar në Lezhë, si i zbuloi policia pas hetimit disa-javor

02 Shtator, 2021 10:18



Madhësia e tekstit: - +

f Policia e Lezhës ka goditur një rast të veprimtarisë kriminale në fushën e narkotikëve dhe armëmbajtjes pa leje, duke arrestuar dy të mitur dhe një 27-vjeçar.

o Në kuadër të operacionit “Shëngjini”, policia ka sekuestruar një sasi lënde narkotike kokainë, të ndarë në doza, gati për shitje, dhe një sasi lënde narkotike cannabis sativa.

o Gjithashtu, janë sekuestruar një armë zjarri pistoletë, 4 krehra, municion luftarak, peshore elektronike, një automjet dhe një sasi lekësh të dyshuara të përftuar nga shitja e lëndës narkotike.

Njoftimi i policisë:

Në zbatim të Planit të Masave të hartuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit “Për kontrollin e territorit, parandalimin e ngjarjeve kriminale, kapjen e autorëve që mbajnë armë zjarri pa leje, atyre që shpërndajnë lëndë narkotike dhe personave në kërkim”, nga strukturat e Drejtorisë Vendore të Policisë Lezhë, nën drejtimin e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Lezhë, pas një hetimi disajavor, u bë i mundur finalizimi i operacionit të koduar “ Shëngjini”, në kuadër të të cilit u arrestuan në flagrancë shtetasit:

S. Gj., 27 vjeç, me precedentë të mëparshëm kriminal në fushën e narkotikëve dhe të armëmbajtjes pa leje;

L. F., 17 vjeç dhe K. N., 16 vjeç, banues në Shëngjin, Lezhë.

Shërbimet e Policisë Lezhë, bazuar në informacionet e siguruar në rrugë operative për implikimin e këtyre shtetasve në veprimtarinë kriminale të shitjes së lëndëve narkotike në Shëngjin, Lezhë, pas një hetimi disajavor, kanë ushtruar kontroll në ambientin ku këta shtetas, në bashkëpunim me njëri-tjetrin, përgatisnin lëndën narkotike në doza, për shitje.

Gjatë kontrollit të ushtruar në këtë ambient u gjetën dhe u sekuestruan në cilësinë e provës materiale doza më lëndë narkotike të dyshuar kokainë, një sasi lënde narkotike cannabis, armë zjarri pistoletë, municion luftarak, peshore elektronike, një sasi lekësh të dyshuara të përfthuara nga ky aktivitet i paligjshëm dhe një automjet.

Nën drejtimin e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Lezhë vijon puna për identifikimin dhe kapjen e personave të tjerë të përfshirë në këtë veprimtari kriminale.

Materialet i kaluan Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Lezhë, për veprat penale “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”, e kryer në bashkëpunim dhe “Armëmbajtja pa leje”.

(BalkanWeb)

Për t'u bërë pjesë e grupit "Balkanweb" mjafton të klikoni: [Join Group](#) dhe kërkesa do t'ju aprovohet menjëherë. [Grupi Balkanweb](#)

Etiketa: kokaine lezhe

TË NGJASHME

EMRAT/ Po kalonin 9 kg kokainë nga Shqipëria në Kosovë, kush janë dy të rinjtë që u arrestuan në kufi

08 Shtator, 2021

Në kërkim për vjedhje, 29-vjeçari nga Mirdita arrestohet tek Ura e Matit, shihni momentin e ndalimit nga Policia Rugore (Video)

08 Shtator, 2021

Shfaq Komentet (0)

TË FUNDIT NGA -KRONIKË

Kultivuan kanabis në Kryezi të Tiranës/ Kush është biznesmeni që drejtonte grupin, një prej të arrestuarve pendohet dhe pranon të bashkëpunojë me drejtësinë

08 Shtator, 2021

VIDEO/ Hyn për të 'blerë' në argjendari në Gjirokastrë, shihni momentin kur hajduti vjedh byzylykun dhe e fut në xhep

08 Shtator, 2021

Përplasi me makinë 74-vjeçarin me biçikletë, arrestohet i riu në Shkodër

08 Shtator, 2021

EMRAT/ Kultivuan kanabis në Kryezi të Tiranës, 7 në pranga, mes tyre dhe një kryeplak. Sekuestrohen armë e municione

08 Shtator, 2021

VIDEO/ Gara shpejtësie në rrugën 'Migjeni', si ranë në grackën e policisë 5 drejtues mjetesh

08 Shtator, 2021

Kujdes, policia ju vëzhgon! Me shpejtësi skëterrë deri në 167 km/h, penalizohen shoferët rebelë, hiqen 25 patenta

08 Shtator, 2021

KATEGORIA VIDEO



Dashamir Shehi: Berisha non grata? Është çështje personale e tij. Nëse ligji së lejon futjen në Kuvend, KQZ të flasë

Osman Stafa | 08 Shtator, 2021

'Teatri Shëtitës' ringjall qendrat kulturore në rrethe, Kiço Londo: Kemi me shume festivale se shfaqje teatrorë

Fatmira Nikolli | 08 Shtator, 2021

VIDEO/ Hyn për të 'blerë' në argjendari në Gjirokastrë, shihni momentin kur hajduti vjedh byzylykun dhe e fut në xhep

08 Shtator, 2021

Parlamenti i ri, Nazarko: Pres një opozitë me qasje propozuese dhe denoncuese cilësore e korrupsionit. Kosova, të kërkojë nga SHBA përfshirje në dialogun me Serbinë

08 Shtator, 2021

"Vendi i dytë është i kapshëm", Altin Lala në "Sport News": Kombëtarja e ka vetë në dorë fatin

08 Shtator, 2021

EMRAT/ Kultivuan kanabis në Kryezi të Tiranës, 7 në pranga, mes tyre dhe një kryeplak. Sekuestrohen armë e municione

08 Shtator, 2021

FAKET ZYRTARE

News24

Gazeta Shqiptare

Radio RASH

PRIVATËSIA

POLITIKA E PRIVATËSISE

KONTAKT

redaksia@balkanweb.com

EMISIONE NEWS24

Alert

Emisioni Diplomaticus

Emisioni Vila 24

Kjo Javë

Klinika 24

Koha për t'u zgjuar

Me zemër të hapur

Monitor Ekonomi

Real Story

Shqiptarët për shqiptarët

Sport News

Sport News Plus

KATEGORI

Fillimi

Shqipëria

Kosova

Rajoni

Sport

Bota

Kulturë

Metropol

Analiza

Teknologji

MEDIAT E HUAJA

New York Times

Guardian

WEB BBC

WEB CNN

REUTERS

Washington Post

Times Online

Financial Times

WEB Yahoo

WEB MSN

USA Today